



KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

27/07/2021

KOMUNA E SUHAREKËS - KOMUNA E SUHAREKËS OPSTINE SUVA REKA - OPSTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
KRYEZIMI - PRILJENO - RECEN			
Numri i Dok. Arkivike Q. i. 011	Numri i Braj Number	Shtesa Fillore Appendix	
01	016	42754	2

Duke u bazuar në nenin 13, 58 dhe 34, të Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale, Nr-03/L040, dispozitive të statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kryetari i Komunës në Suharekë me datë 27.07.2021, lidhë këtë :

Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Bashkëfinancimi

në mes të

Shoqata Grejkoci

dhe

Komunës së Suharekës

Neni 1

Objekt i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi lidhet në mes të Shoqatës Grejkoci, të përfaqësuar nga **Regjep Neziraj, Kryetar i Shoqatës**, dhe Komunës së Suharekës, të përfaqësuar nga **Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës**, me qëllim të financimit të projektit për realizimin e projektit Parkut Qaliatë në fshatin Grejkoc.

Neni 2

Kushtet për formimin e kësaj marrëveshje

Kjo marrëveshje parasheh ndërtimin e Parkut Qaliatë në fshatin Grejkoc, Komuna e Suharekës, i cili do të shërbejë për banoret e këtij lokaliteti.

Neni 3

Qëllimi i marrëveshjes

- 3.1 Komuna me qëllim të krijimit të kushtëve sa më të mira, dhe ambient sa më të pastër për banoret e këtij lokaliteti dhe
- 3.2 Shoqatës Grejkoci në mënyrë vullnetare, të pavarur dhe vullnetë plotë, obligohet dhe zotohet për implementimin dhe realizimin e këtij projekti.

Neni 4

Obligimet e Shoqatës

- 4.1 Shoqatës Grejkoci është institucioni implementues i këtij projekti i cili parasheh periudhën e ndërtimit të Parkut Qaliatë në fshatin Grejkoc.

